

ELYSIUM

Nr. 3 Prishtinë, Dhjetor 2005

*Stili i jetës
dhe lidhjet gejë*

VIRGJINAT

Aleksandri i Madh

Përmbajtja



Përgjegje për orientimin seksual

4



Kuptimi i vërtetë i ish-gejve

5



Me të kuptuar se je gej

6-8



Deklarata e APA-s

9



Stili i jetës dhe lidhjet gejë

10-11



Virgjinat

12-13



Aleksandri i Madh

14-15



Opinione

16



Hepatiti B dhe C

17-19

Fjala e redaksisë

Të nderuar lexues!


Kur filluam të shkruajmë artikujt e numrit të parë të broshurës, e kishim mjaft vështirë. Nuk e dinim nëse do të ishin materialet atraktive apo jo, gjithashtu ekzistonte një frikë e brendshme, nëse do të kishte sukses kjo iniciativë e jona. Tani pas nëntë muajsh po e shohim se megjithatë e gjithë kjo iniciativë doli me rezultate të shkëlqyeshme. Edhe pse vetëm tre numra, ne e plotësuam planin tonë të cilin e kishim menduar. Për nëntë muaj shoqata jonë botoi broshurat me plot e përplot informacione që besojmë të kenë qenë interesante dhe atraktive për ju lexues të nderuar.

Shoqata jonë tashmë e ka krijuar përvojën dhe idenë e përpilimit të kësaj broshure. Në vitin tjetër do të vazhdojmë me numrat e tjerë të ardhshëm dhe besojmë se do të jenë shumë më interesante si nga përmbajtja po ashtu edhe nga dizajni. Do të mundohemi që në numrat e ardhshëm të tregojmë më shumë profesionalizëm.

Mund të them se ky vit ishte një vit shumë i frytshëm në shoqatë dhe shpresojmë se edhe për ju lexues të nderuar viti 2005 kishte ndryshime pozitive.

Shoqata "Elysium" të gjithë lexuesve iu uron Vitin e Ri 2006 dhe iu dëshiron shumë suksese.

Lexim të këndshëm,
Bordi drejtues i Shoqatës "Elysium".



Përgjigje për orientimin seksual

Pse të dalurit publik është i vështirë për disa gejë?

Për disa gejë procesi i të dalurit publik është i vështirë, derisa për disa të tjerë nuk është. Zakonisht gejë kur e kuptojnë se orientimi i tyre seksual është i ndryshëm nga normat e komunitetit, ndjejnë frikë, vështirësi dhe ndihen të vetmuar. Kjo është e vërtetë veçanërisht për ata persona që e kuptojnë në moshën e fëmijërisë ose adoleshencës se janë gejë, që nuk është e pazakonshme. Dhe varësisht nga familjet e tyre dhe ku jetojnë, ata duhet të luftojnë kundër paragjyqimeve dhe informimit jo të drejtë për homoseksualitetin.

Fëmijët dhe adoleshentët mund të jenë veçanërisht të ndjeshëm nga efektet e dëmshme të paragjyqimeve dhe të stereotipeve. Ata gjithashtu mund të kenë frikë nga refuzimi prej familjes, shokëve, bashkëpunëtorëve dhe nga institucionet religjioze. Disa gejë duhet të brengosen për humbjen e vendit të tyre të punës ose të bezdisen në mënyrë të përsëritur në shkollë nëse identiteti i tyre seksual bëhet i njohur.

Çka duhet bërë për t'i tejkaluar paragjykimet dhe diskriminimin që gejë të përjetojnë?

Hulumtimet kanë treguar se njerëzit që kanë qëndrime pozitive ndaj gejëve janë ata të cilët thonë se njohin mirë një ose më shumë gejë, shpesh si shokë ose si bashkëpunëtorë. Për këtë arsye, psikologët besojnë se qëndrimi negativ ndaj gejëve si një grup janë paragjyqime që nuk bazohen në eksperiencën aktuale por janë të bazuara në stereotipe dhe paragjyqime. Gjithashtu, mbrotja nga dhuna dhe diskriminimi janë shumë të rëndësishme, aq sa është e rëndësishme për çdo grup minoritar. Në disa shtete dhuna trajtohet kundër një individi në baza të orientimit të tij/saj seksual si një krim që vjen nga urrejtja që të tjerët kanë ndaj gejëve.



Pse është e rëndësishme që shoqëria të jetë më mirë e informuar për homoseksualitetin?

Edukimi i të gjithë njerëzve për orientimin seksual ngjan t'i pakësojë paragjykimet anti-gej. Informatat e sakta për homoseksualitetin janë posaçërisht të rëndësishme për të rinjtë që për herë të parë e zbulojnë dhe kërkojnë ta kuptojnë seksualitetin e tyre, se a janë

homoseksualë, biseksualë apo heteroseksualë. Frika se qasja e informatave të tilla mund të krijojë më shumë njerëz gejë nuk ka kurrëfarë baze, informatat për homoseksualitetin nuk kanë mundësi ta bëjnë dikë gej apo heteroseksual.

Kuptimi i vërtetë i "ish-gejve"

"Terapia reperative" apo terapia e "konversionit" bazohet në të kuptuarit e homoseksualitetit si të tillë që është refuzuar nga të gjithë profesionistët shëndetësor dhe atyre të shëndetit mental.

Nga Asociacioni Amerikan i Psikiatërve (APA)

Termi "Terapia reperative" i referohet psikoterapisë që ka për qëllim eliminimin e dëshirave homoseksuale dhe përdoret nga njerëzit të cilët nuk mendojnë se homoseksualiteti është një variant i orientimit seksual të njerëzve, por ende besojnë se homoseksualiteti është çrregullim mental.

Fakti më i rëndësishëm i "Terapisë reperative" është se bazohet në të kuptuarit e homoseksualitetit si të tillë që është refuzuar nga të gjithë profesionistët shëndetësor dhe atyre të shëndetit mental.

Akademia Amerikane e Peditërve, Asociacioni këshillues i Amerikës, Asociacioni Psikiatrik i Amerikës,

Asociacioni Psikologjik i Amerikës, Asociacioni Kombëtar i Psikologëve shkollor dhe Asociacioni Kombëtar i Punonjësve Social, që të gjithë së bashku përfaqësojnë më shumë se 447,000 profesionist shëndetësor dhe të shëndetit mental, kanë marrë pozicion të njëjtë se homoseksualiteti nuk është çrregullim mental dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për "shërim".

Manuali i Diagnostikimit dhe Statistikave të Çrregullimeve Mentale (Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders)-DSM i publikuar nga Asociacioni Psikiatrik i Amerikanëve, i cili i definon standardet e fushave, nuk e përfshin homoseksualitetin si çrregullim mental. Të gjitha organizatat kryesore të tjera profesionale shëndetësore kanë përkrahur Asociacionin Psikiatrik Amerikan në skualifikimin e homoseksualitetit si çrregullim mental qysh në vitin 1973. Prandaj, ideja se homoseksualiteti është çrregullim mental ose që dëshirat seksuale të gjinisë së njëjtë në mesin e disa adoleshentëve është në një mënyrë jo normale, nuk ka përkrahje në mesin e organizatave të profesionistëve shëndetësor dhe atyre të shëndetit mental.



Me të kuptuar se je gej

Në moshën e adoleshencës e kupton se je gej. Le të themi se kjo është periudha kur personi në veten e tij e zhvillon të kuptuarin e seksualitetit të tij. Të qenurit gej është seksualiteti yt. Kështu që nuk do të mund të luftosh kundër kësaj e as mos u mundo të krijosh nga kjo ndonjë definicion për vetveten. Ti ke vlerë më shumë se kaq. Ke emrin tënd, i ke mendimet e tua, ndjenjat e tua, trupin tënd, punët tënde...

Gej, do të thotë ta kesh seksualitetin e atillë që është i orientuar drejt personave të gjinisë së njëjtë. Dhe kjo është e tëra. Mos u bazo në traditën, fenë, qëndrimet e rrethit, gjykimet e instancave më të larta, e kush e di çka tjetër. Je ai që je dhe lirohu nga ndikimet e mendimeve të tjerëve, të cilët të imponojnë vetëm akuza. A e ke pranuar faktin se je gej? A e ke pranuar me të vërtetë? A je i vetëdijshëm se mund t'a duash një djalë dhe mund të kesh lidhje shumë të bukur me të? A ke miqë që do të dojnë ashtu si je dhe do ta pranojnë seksualitetin tënd? A e do veten? Të lutem tani përsëri mendo për secilën


pyetje sepse janë vendimtare. Qëndrimi i të tjerëve absolutisht do të varet nga qëndrimi yt ndaj vetes tënde. Më beso, sepse kjo është përvojë e shumëkujt.

Ji i sigurt se je gej, ji i sigurt se nuk je i pamoralshëm, se nuk je i sëmurë dhe i shëmtuar. Të lutem, bëhu i sigurt dhe përsëritja vetes çdo ditë kur të zgjohesh në mëngjes se e çmon secilën pjesë tënde. Tërë këtë merre me seriozitet. Çdo mendim i ri duhet të përsëritet shumë herë deri sa t'a pranosh se je duke e shqyrtuar. Qëndrimi pozitiv ndaj vetes ndërtohet për një kohë të gjatë dhe me shumë mund.

Një gej sikurse edhe një heteroseksual mund të jetë i mirë ose i keq. Ose, thënë më mirë, mund të bëjë vepra të mira dhe të këqija. Nuk ekzistojnë mëkatet por ekziston vetëm gabimi ndaj vetvetes. E kjo është kur vetveten e bën të palumtur.

Gjendja normale e njeriut janë begatia dhe lumturia. A mendon se kjo është marrëzi? A nuk iu këndojnë të gjithë dhembjes dhe dashurisë, fetë a nuk i përmendin vuajtjet, shkrimtarët a nuk shkruajnë për absurditetet...? Pra mendo. Kujt në këtë gjithësi i intereson se a je i palumtur? Kur dashuron, nuk ka shqetësim.

Dashuria është ajo që të bën të lumtur, kurse qetësia dhe besimi se çdo gjë do të jetë në rregull të bën që të jetosh në begati. Begatia nuk do të thotë kuleta plot (megjithëse mund t'i përfshijë edhe paratë). Begatia është gjendja kur jeton në mirëkuptim më të tjerët dhe kur jeton me të vërtetën. Atëherë, nuk ke arsye për të vuajtur dhe të shpenzosh energji për t'u fshehur. Para se të mendosh: "pse e tërë kjo?" të mendojmë tani për mundimin tënd.



Çka do të thotë katastrofa në familje?

Nuk e di se çfarë është familja jote, a është patriarkale ose liberale, a je fëmijë i vetëm dhe se çfarë i ke motrat ose vëllezërit. Të themi se tani kjo është e parëndësishme. Paramendo tani sesi familja jote është e parëndësishme. Paramendo sesi ka ndodhur një tragjedi dhe të gjithë kanë vdekur. Paramendo se ke mbetur vetëm. Sado që dhembja do të pikëllonte, përsëri do të mbetesh ai që je. Pse mendon se të jesh gej në familje është katastrofë? A nuk është katastrofë më e madhe ajo që mendon se seksualiteti yt mund të jetë burim i problemeve dhe i jolumturisë? Pse paraprakisht e akuzon veten se je ndonjë burim i katastrofës? A mendon se prindërit ose vëllezërit e tu nuk kanë bërë gabime që i afrohen katastrofës?

Mendo, se shumica e njerëzve dikur e lëshojnë familjen në të cilën kanë qenë, pavarësisht nga seksualiteti i tyre. Kështu do të bësh edhe ti. Dhe atëherë kujt do t'i frikësohesh që do ta shpallte seksualitetin tënd katastrofë?



Mendo përsëri, se ndaj çka do të jetë kjo katastrofë? A thua ndaj asaj që njerëzit tuaj presin nga ti që të jesh heteroseksual, që të kesh jetë të cilën ata mendojnë se duhet ta kesh?

Këto quhen pritje të gabueshme dhe ti e di shumë mirë se shumë prindër kanë pritje të tilla nga fëmijët e tyre: bëhu mjek, avokat, automekanik, ... e fëmiu është shpirt në vete dhe i ka dëshirat dhe aspiratat e veta. Bëhu ai që dëshiron të bëhesh. Prindërit dhe familja jote nuk kanë asnjë të drejtë në ty e as të të tregojnë sesi të ecësh e me kënd të flesh. Ti je vet përgjegjës për vetveten.

Arsyeja, pse dikush të kalindur, të ka ushqyer dhe të ka rritur, nuk i jep kurrëfarë të drejte që as bile të supozojë se çka është më e mira për ty. Mos beso në rrëfimet e më të vjetërve për përvojat e tyre, së pari pyeti se a janë ata vetë të lumtur në martesë, në seks, në punë... Do të befasoheh sesa prej tyre do të përgjigjen me "jo", por ja që ata të gjithë veprojnë ashtu sepse edhe të tjerët kanë vepruar ashtu. Lirohu nga shabloni i sjelljes. Mendo sikur të mos ta kishe ngarkesën e familjes dhe të njohjes, a do të ishte me të vërtetë i knaqur me veten si gej? A është ky fakti i vetëm që të bën të palumtur në seksualitetin tënd?

Shkojmë tani në atë që ti do ta quaje "bota reale". A jeton me familje? A je i varur ose jo financiarisht? Kjo është shpesh shablon i kërcënimit; "Nuk do të jesh peder deri sa unë të ushqej"... A ke frikë nga kjo? A i frikësohesh humbjes së sigurisë, nëse ata ta ofrojnë këtë? Atëherë mendo që sa më shpejtë të pavarësohesh! Dhe nëse kjo të bën më të sigurt, atëherë, tregoj u atyre. A është me të vërtetë se familja nuk do të të pranonte, apo kjo është një pasiguri e jotja në veten tënde për faktin që je gej? A mendon se me këtë do ta lëndosh dikënd?

E di që shumica e prindërve do të hamenden sesa janë fajtorë që "djali i tyre është peder". Gjithashtu e di se ata do të mundohen të luajnë lojëra të thjeshta të nënçmimit dhe të kërcënimit si: "Ne t'i kemi dhënë të gjitha e ti je peder! Ti këtë po e bën vetëm që të na dënosh, por ne do të bëjmë gjithçka që ti të shërohesh. Mos u dorëzo"... Këto janë vetëm lojëra të pritjeve të tyre për të kontrolluar ose mendojnë se dijnë çka është më e mira për ty. Kurse, ne tashmë kemi mësuar se absolutisht vetëm ti je përgjegjës për veten tëndel! Sepse, ti e di më së miri se çka është e mirë për ty. Më beso, se edhe prindërit shumë të mbyllur dhe patriarkal në fund dijnë shumë mirë ta pranojnë se je gej. A e kuptove pse të thashë që është më rëndësi që së pari t'i pastros gjërat me vetveten? Nëse je i sigurt, më beso se do t'i mbijetosh të gjitha çastet e pakëndshme. Bëhu i fortë në qëndrimin tënd. Familja është shumë e shkathët në luajtjen e nënçmimeve dhe kërcënimeve emotive. Bëhu më i fortë se lojërat e tilla. Ne, të cilët tani jemi të lumtur, kemi qenë më të fortë...

Dhe më në fund

Mbaj në mend se të presin edhe shumë sfida dhe se familja do të jetë në fund, vetëm një nga gjërat e vogla që do t'i keni në listën e kujtimeve. Kjo përvojë do të jetë e thellë dhe e pasur dhe nëse vepron drejt, nga familja juaj do të mund të bëni që të jenë persona më të mirë. E vërteta bën çudira, përvoja e madhe e jetës sime ka qenë mu kjo fjali e shkurtër! Dhe ka bërë çudira që mund të krahasohen me përallat. A kam thënë atë se gjendja e jonë e natyrshme, është gjendja e lumturisë dhe e begatisë?

Mbaj në mend, ti je i rëndësishëm për veten tënde. Familjen krahasoj me një vazo në të cilën rritet lulja, familja nuk është dheu që e përcakton se çfarë lule do të bëhesh ti. Ti je unikat, e meriton dashurinë dhe e meriton ta japësh atë. Së fundi, njeriu lind dhe vdes vet. Njerëzit e tjerë janë vetëm kalimtarë qoftë edhe po ta kalonin tërë jetën me ju. Mësohet mendosh sesa i rëndësishëm je për veten tënde.

Po e përsëris, në çdo mëngjes zgjohu me ndjenjën sesa shumë po e çmon secilën pjesë tënde.



Deklarata e Shoqatës Amerikane të Psikologëve për homoseksualitetin



Hulumtimet mbi homoseksualitetin janë shumë të qarta. Homoseksualiteti nuk është as sëmundje mentale e as shthurje morale. Thjesht, është një mënyrë sesi një pakicë e popullatës tonë e shpreh dashurinë njerëzore dhe seksualitetin. Janë bërë studime pas studimesh për shëndetin mental të gejve. Studimi i të gjykuarit, stabilitetit, besueshmërisë, mbështetjes dhe të adaptimit social dhe profesional, që të gjitha tregojnë se gejët funksionojnë në secilën sferë jetësore sikurse edhe vet heteroseksualët.

Homoseksualiteti nuk është çështje e zgjedhjes individuale. Hulumtimet sugjerojnë se orientimi homoseksual zë vend shumë herët në ciklin jetësor, ndoshta edhe para lindjes. Homoseksualiteti është gjetur në rreth 10% të popullatës, shifër kjo që befasisht është konstante në mjedisë të ndryshme kulturore, pa marrë parasysh vlerat dhe standardet e ndryshme morale të një mjedisi të caktuar kulturor. Përkundër asaj që disa lënë të kuptohet, prania e homoseksualitetit në një popullatë nuk duket se mund të ndryshojë me praninë e kodeve të reja morale ose nga ndryshimet në shoqëri. Të arriturat hulumtuese sugjerojnë se përpjekjet për t'i "riparuar" homoseksualët janë asgjë më shumë se paragjykim shoqëror i veshur në petkun psikologjik.

Të gjitha objektivat e diskriminimit, qofshin ata zezakët, femrat, të hendikepuarit ose sektet religjioze kanë një shtrirje specifike dhe të tmerrshme në vuajtjen e tyre. Kjo, po ashtu, është e vërtetë edhe për gejët. Nga ana psikologjike, seksualiteti dhe orientimi

seksual përfaqësojnë forcat jetësore të cilat e formojnë gurthemelin më të ndjeshëm të qenies sonë. Ata jo vetëm që u japin formë qëndrimeve dhe pasioneve tona por janë edhe aq themelore për strukturën tonë të personalitetit ashtu që në pjesë të madhe e përcaktojnë ndjenjën e unitetit personal dhe shkallën tonë të komoditetit në rreth. Ata janë forca shtytëse me të cilën ne shprehim dashurinë, punojmë dhe krijojmë. Për pacientët (në psikoterapi), pretendimi social se homoseksualiteti "është" sëmundje dhe/ose imoralitet krijon një burg emocional, ndjesor dhe shpirtëror ku vetëshprehja, dashuria dhe format më të thella të lidhjes budallallepsen përmes fajit të ankthit dhe të vetëneveritjes. Për ata nga ne në psikologji që kanë pasur këtë lloj përjetimi në punë me gejët, ndikimi ka qenë shumë i thellë. Për më shumë se dy dekada, Shoqata Amerikane e Psikologëve ka përkrahur eliminimin e diskriminimit të gjeve.

Së fundi, nëse dikush mendon për problemet e shumta reale që e konfrontojnë shoqërinë tonë dhe që sulmojnë strukturën e familjes sonë, probleme si dhuna në familje, shkurorëzimi, përdorimi i drogës dhe i alkoolit, abuzimi i fëmijëve, njerëzit e pastrehë dhe izolimi, bëhet e qartë se individët që janë të preokupuar për së tepërmi me atë sesi një pakicë e qytetarëve tonë e shprehin dashurinë dhe seksualitetin natyrisht kanë krijuar një numër të prioriteteve më të veçanta si për vetën e tyre ashtu edhe për të tjerët.

Çështja e vërtetë me të cilën ballafaqohet sot shoqëria jonë nuk është pse njerëzit e kërkojnë dashurinë dhe kuptimin kur tashmë e bëjnë atë por pse për disa është aq e vështirë të dashurojnë dhe të kuptojnë.

Stili i jetës dhe lidhjet gejë

Mënyra e të jetuarit si gej ka filluar të ndryshojë paksa gjatë këtyre viteve të fundit. Të rinjtë sot, për dallim nga e kaluara kanë filluar të shprehen më lirshëm për ndjenjat e tyre seksuale. E gjithë kjo do të thotë se ne Kosovë ka lëvizur diçka për të mirë në këtë drejtim. Jo më shumë se para dhjetë viteve po të flitet për të qenurit gej, ka qenë diçka e tmerrshme, e turpshme, e papranueshme për gjeneratat e vjetra gjë që ka bërë të pamundur që dikush të pranojë të thotë se, jam ai që jam edhe pse në ato kohëra gejët nuk kanë munguar. Zgjedhja për të gjetur mënyrën më të mirë, sesi të jetojnë gejët është çështje e nevojës personale. Por, edhe në ditët e sotme nuk është edhe aq e lehtë rruga për të gjetur mundësin që t'ia arrijmë këtij qëllimi. Për shembull, ka shumë gejë që sot jetojnë të izoluar, të vetmuar duke i ndrydhur ndjenjat e tyre jo me dëshirë, por të imponuar nga rrethi. E gjithë kjo vjen nga frika e kanosjes së ndonjë rreziku e cila është përfundimisht frustruese. Por ka të atillë që për t'i ikur thashethemeve bëjnë jetë të dyfishtë duke pasur lidhje me të dy gjinitë sepse besojnë se kjo mënyrë e jetës është zgjedhja më e përshtatshme. Pengesa për të jetuar ashtu si dëshirojmë mund të ketë pasoja të pa parashikuara.

Te arriturat ne këtë drejtim... të pakta janë rastet kur dy gejë jetojnë së bashku, e që kjo do të ishte zgjedhja më e duhur. Pra, definimi i stilit të të jetuarit si gej është shumë i paqartë, gjë për të cilën duhet punuar në mënyrë që nevojat e këtyre personave të ndryshojnë sipas rrethanave dhe mundësive



Të jetuarit vetëm

Mënyra e jetës te gejët ndryshon, varësisht se për cilët persona flasim dhe cilat janë kushtet dhe rrethanat në të cilat gjenden ata. Si heteroseksualët njësoj edhe gejët ëndërrojnë dhe kanë të drejtë të kenë një partner për të kaluar një jetë të qetë. Megjithatë pengesat nuk mungojnë, gjë që e vështirësojnë realizimin e kësaj ëndërrë.

Arsyeja që shumë gejë i bën të jetojnë të vetmuar është frika se do të hasin në ndonjë reagim të tmerrshëm nga familja dhe rrethi ku jetojnë. Problem tjetër është edhe çështja financiare, sepse papunësia në vendin tonë është tejet e madhe.

Këto janë disa nga arsyet që e pamundësojnë bashkëjetesën e gejve, e që për ata paraqet destabilizim të jetës. Mentaliteti dhe papunësia janë dy nga pengesat kyçe që në të shumtën e rasteve pa dëshirën e tyre ata imponohen që të jetojnë në bashkësi familjare. Ky detyrim

mund të shkaktojë pasoja të mëdha për gejtë. Si për shembull: mbyllja në vetvete, ashpërsimi i tyre ndaj rrethit ku jetojnë. Gjithashtu mund të devijojnë drejtimin e jetës, si: përdorimi i pijeve alkoolike, dhe konsumimi i narkotikëve. Por çka mund të themi se gjithëherë dhe gjithmonë shpresa vdes e fundit, kështu që duhet të jemi optimist se në një të ardhme jo të largët, edhe për gejtë, dielli do të lind ashtu si për mbarë njerëzimin.

Të jetuarit me persona të të dy gjinive

Rastet më të shumta janë kur gejtë janë në lidhje martesore me gjininë e kundërt dhe ndërkohë kanë marrëdhënie seksuale edhe me partner të gjinisë së njëjtë. Kjo është një mënyrë tjetër e të jetuarit dhe qasje më e volitshme për të qenë në kontakt me gejtë. Kjo dukuri është më shumë e pranishme të gejtë më të moshuar, por nuk do të thotë se rastet e tilla nuk mungojnë edhe sot.

Martesa e domosdoshme

Në kulturën dhe traditën tonë, po nuk u martua një mashkull konsiderohet gjest i pahijshëm dhe jo i zakonshëm.

Imponimi për t'u martuar, shpesh herë bën që të ikim nga realiteti e të martohem por kjo nuk na shpie askund vetëm drejt tradhëtisë martesore. Po aq sa e gënjen bashkëshortin/en aq e maletreton edhe vetveten gjatë gjithë jetës. Pra, çfarë do të ndodhte po të kuptojë bashkëshorti/ja se ju e dashuroni një person të gjinisë së njëjtë dhe jo atë? Se jeni martuar me atë vetëm sa për "sy e faqe"? Sigurisht se do të jetë shkatërruese për atë. E dhembshme por e vërtetë. Rastet e tilla për shkak të rrethanave të ndryshme kanë ndodhur në të kaluarën, e që po përsëriten edhe sot.

Ky është realiteti, sado i vrazhdë që është por lind pyetja deri kur ?

Drejtesi është të jetosh ashtu siç dëshiron ose me kënd dëshiron... ia vlenë të sakrifkohet për të qenë i lumtur. Mendoj se po...

Të jetuarit së bashku

Kohët e fundit në Kosovë ka raste kur dy gejtë jetojnë bashkë. Nuk është e lehtë të kalohen barrierat e tilla, sepse te ne kjo konsiderohet ndryshim i tmerrshëm i jetës, ngase kjo do të thotë braktisje e zakoneve dhe traditave të vjetra. Këto tradita e vështirësojnë më shumë bashkëjetesën e gejve, por gjithëherë duhet të nisemi nga ajo që dikush duhet të fillojë ndryshime të tilla, të kalojmë nëpër rreziqe të paparashikuara vetëm e vetëm që gjeneratave të ardhshme t'u mundësohet që të bisedohet hapur për ndjenjat emocionale me prindërit e mos të jenë temë tabu ashtu siç janë sot. Megjithatë, ëndërra e çdo geji është që të jetojë me të dashurin e tij dhe të ketë jetë të rehatshme. Qëllimi duhet të mbizotërojë mbi realitetin në të cilin ndodhemi për momentin . Çiftet e tilla janë model për t'u treguar gjithë të tjerëve se ia vlen të sakrifkohet për të gjetur mënyrën më të mirë dhe më të përshtatshme për të jetuar.



Virgjinat

Vajzat e betuara (virgjinat) kanë jetuar në Malësinë e Shqipërisë së veriut dhe në Kosovë. Ato betoheshin në beqarinë dhe e pranonin veshjen dhe rolin e mashkullit në shoqëri. Qysh në fëmijëri prindërit e tyre betoheshin se vajza e tyre do të bëhej virgjinë, kryesisht nga shkak që nuk kishin fëmijë mashkull i cili do të trashëgojë dhe udhëheq familjen patriarkale. Disa femra tjera zgjidhnin me vetëdëshirë që të bëheshin virgjina në mënyrë që t'i shmangen martesës me personin i cili nuk i pëlqente (në të kundërtën, refuzimi i martesës do të

shkaktonte përlëshje të përgjakshme me familjen e fyer të djalit).

Në librin e Antonia Young "Gratë të cilat u bënë meshkuj: virgjinat shqiptare", ajo analizon shumë raste të virgjinave të vërteta (për këtë dukuri kanë shkruar edhe shkencëtarë të tjerë, si Dickemann, Gremaux dhe Whitaker). është interesante që fenomeni paraqitet pavarësisht nga religjioni: ato janë të fesë Islame dhe të Krishterë. Detajet kryesisht janë të njëjta: virgjinat i qethnin flokët, merrnin emër mashkulli, dhe visheshin në rroba të meshkujve. Ato janë të respektuara njësoj sikur edhe meshkujt, mbanin armë dhe merrnin pjesë në përlëshje të përgjakura. Ato gjithashtu edhe pinin duhan, pshtynin, kryenin punë të rënda dhe nuk ishin të kufizuara në punët e shtëpisë siç janë zakonisht të kufizuara femrat tjera.

Në kulturën në të cilat virgjinat jetonin, theksohet me dallime të mëdha të rolit dhe statusit të gjinive. Femrat i bëjnë punët e shtëpisë, banin ujë, dru për zjarr dhe kujdeseshin për fëmijët. Në shoqërinë rurale të shqipëtarëve me shekuj ka mbizotëruar ligji i Kanunit. Pasi që e tërë shoqëria ishte patriarkale, patrilokale dhe patrilineare, djemtë kishin më shumë vlerë sesa vajzat. Vetëm në këtë lloj të kulturës është e logjikshme që femrat mund të jetojnë si meshkuj derisa, siç e thekson Young dhe të tjerët, nuk egzistojnë meshkuj të cilët jetojnë si femra ngase kjo do të ishte humbje e turpshme e statusit. Në këtë mënyrë virgjinat i përshtaten modelit të "Progresit narrativ" të Gerberit ndërsa shumë hulumtues në të vërtetë i theksojnë motivet ekonomike të virgjinave dhe të familjeve të tyre.



Foto e publikuar në vitin 1907 në "Die Woche" Nr. 40, në artikullin për Virgjinat e shkruar nga Dr. E. Schultz

Ashtu siç tregon Young, virgjinat paraqesin shembullin e përkryer të "gjinisë si koncept i ndërtuar kulturor". Ato e përkrahin qëndrimin e Judith Butler e cila thotë se gjinia është "bashkësi e veprimeve të përsëritura brenda kornizës së rregullave shumë rigorozë e cila nuk ndryshon në kohë për të prodhuar paraqitjen e substancës së llojit të krijesës natyrale". "Femra" ose "mashkulli" si subjekt stabil plotësisht është inegzistent, i zëvendësuar me sistemin e ashpër të rolit të gjinisë dhe "përsëritjen e stilizuar të veprimeve" të cilët prodhojnë efektin e gjinisë. Në shpjegimin e Young nuk ka paraqitje të subjektiviteteve as edhe mundësitë të cilat mund t'i paraqiten virgjinave të cilat luajnë rolin e mashkullit. Përderi sa nuk mund të martohen për shkak të betimit në beqarinë, disa nga ato flirtojnë me femra dhe sfidojnë në dyluftim secilin i cili e mohon burrërinë e tyre.

Garberi mendon që transvestitizmin mund ta vështrojmë si "hapsirë për zhvillimin e mundshëm dhe ngatërrimin e kulturës". Virgjinat nuk shihen si transvestite, disa i mbajnë emrat femëror, disa e shfrytëzojnë gjininë femërore, por asnjëra nuk e mohon që është virgjinë, megjithatë ato edhe më tutje nuk e "ngatërrojnë kulturën". Funkzioni i tyre në të vërtetë e përforcon kulturën patriarkale. Një nga rregullat kryesore të kulturës hegjemoniste është që mashkulli duhet të jetë i lindur me trup mashkullor dhe se familja duhet ta ketë në krye mashkullin. Young shkruan që "fenomeni i virgjinave" në Shqipëri pak e tërheq vëmendjen. Me fjalë të tjera virgjinat nuk janë të dukshme në kulturën si tërësi. Shumë vështirë mund të pritet që ato të jenë kryengritëse të cilat e lëkundin, siç shkruan Butler, me marshimin e gjinisë i cili eliminon "kulturën hegjemoniste dhe

pohimet kritike të saj mbi natyralizimin ose identitetet themelore të gjinisë".

Fenomeni i virgjinave ka qenë inspirim për shumë shkrimtarë, të cilët e kanë shtjelluar këtë fenomen në veprat e tyre. Disa nga ata janë: Josip Relat në veprën e tij "Nita", Alice Munro në veprën e saj "The Albanian Virgin" dhe Elisabet Kleveland Miller në veprën e saj "Pran of Albania".



Një foto tjetër e publikuar në vitin 1907 në "Die Woche" Nr. 40, në artikullin për Virgjinat e shkruar nga Dr. E. Schultz

Aleksandri i Madh (356 - 323 p.e.s)

Mbreti i Maqedonisë dhe pushtuesi i botës.

Ai rrëzoi perandorinë e Persisë dhe i zgjeroni ligjet e veta nga Greqia në Egjipt dhe deri në Indi. E arritura e Aleksandrit vuri themelet e botës Helene, Perandorisë Romake si dhe përhapjes së Krishterizmit. Të gjitha shkrimet e Biblës së Re ishin në gjuhën greke si rezultat i ndikimit të Aleksandrit.

Si dukej Aleksandri?

Për Aleksandrin thuhej se ishte shumë i bukur. Janë bërë shumë portrete të tij mirëpo kopjet e portreteve romake mund të jenë më të saktë. Ai ishte me një trup mesatar, për të gjithashtu thuhej se kishte një aromë të trupit shumë të këndshme, që për atë kohë ishte jo e zakonshme. I dashuri i tij Hephaestioni ishte më i gjatë madje edhe më i bukur. Mbretëresha e Persisë do t'i përkulej atij në vend të Aleksandrit kur ajo u prezentua para tyre. Aleksandri i kishte thënë mbretëreshës: "S'ka gjë, Mbretëreshë, Hephaestioni është gjithashtu Aleksandër".



Si e dijmë që Aleksandri ishte gej?

Në Greqi 2.300 vjet më parë ishte e zakonshme që meshkujt të kishin gra dhe dashnorë të të dy gjinive. Babai i Aleksandrit, Filipi i Maqedonisë, kishte dashnorë meshkuj dhe shumë gra. Me shumë nga këto gra ai kishte patur fëmijë. Kjo shkaktoi probleme rreth trashëgimisë së fronit. Shumë nga gjysmë-vëllezërit luftuan mes veti deri në vdekje për të marrë fronin. Në këtë kohë Aleksandri refuzoi të martohej dhe u largua nga Maqedonia për të pushtuar botën.



Aleksandri e dashuroi shokun e fëmijërisë, Hephaestionin. Që të dy ishin djem të zgjuar dhe ishin nxënës të Aristotelit me të cilin Hephaestioni mbajti korrespondencë për një kohë të gjatë. Aleksandri dhe


Hephaestioni e ndjenin veten si Akili dhe Patrokli, heronj të Iliadës së Homerit, që ishte libri më i dashuri i Aleksandrit

Hephaestioni e filloi karrierën e tij ushtarake si kalorës i thjeshtë dhe u ngrit nëpër grada në bazë të meritave të tij ushtarake dhe më vonë u emërua në pozitat më të rëndësishme ushtarake dhe administrative në ushtrinë e Aleksandrit të Madh.

Më vonë, Aleksandri u dashurua me një oborrtar të Persisë së pushtuar dhe ky ishte një akt skandaloz për atë kohë, jo pse ishte dashuruar në një mashkull por pse i dashuri i tij ishte Persian. Në atë kohë shumica e Grekëve popujt e tjerë i konsideronin barbarë. Më vonë Aleksandri u martua me një princeshë nga një mbretëri e largët e Azisë por ende nuk është e qartë nëse ai e donte atë apo jo, pasi që i vetmi fëmijë që u lind nga ky çift ishte një djalë që lindi shumë vjet më vonë pas martesës së tyre. Ai po ashtu u martua me vajzën e mbretit të Persisë të cilën e pushtoi. Kjo ishte një martesë e pastër politike. Hephaestioni u martua me motrën e princeshës pasi që ai

dhe Aleksandri dëshironin që fëmijët e tyre të ishin kushërinj.

Pasi që pushtuan Azinë, Hephaestioni vdiq papritmas nga tifoja. Dhembja e Aleksandrit për Hephaestionin ishte e madhe. Pas vdekjes Hephaestioni u shpall hero. Në



Greqinë antike besoj se heronjtë ishin vetëm një gradë më poshtë sesa Zoti. Pasi që Aleksandri besonte se e kishte fituar hyjninë, ishte i sigurt se do të takonte të dashurin e tij në botën tjetër në vendin ku "zotërat dhe heronjtë jetojnë së bashku". Pasi që e la gruan e tij shtatëzënë ai u sëmur dhe vdiq pa e pritur lindjen e fëmijës së tij. Kjo ndodhi vetëm tetë muaj pas vdekjes së Hephaestionit, siç ndodhi me Akilin dhe Patrokusin në Iliadën e Homerit.

Aleksandri vdiq në moshën 32 vjeçare.

Çfarë thonë të tjerët për Aleksandrin e Madh

Shumë filozofë, historianë dhe shkrimtarë shkruajtën për jetën dhe veprën e Aleksandrit të Madh.

Filozofi Robin Lane Fox në veprën e tij "Aleksandri i Madh" shkruan:

Hephaestioni ishte mashkulli të cilin Aleksandri e dashuronte dhe gjatë gjithë jetës marrëdhënia e tyre ishte shumë intime. Aleksandri i Madh vetëm një herë u mund dhe kjo ishte nga kofsha e Hephaestionit.

Truprojat besnike të Aleksandrit ishin fisnik

të cilët Aleksandri i dashuronte dhe iu besonte. Ndër ta ishte Leonatusi i cili ishte i famshëm për trupin e tij të bukur prej atleti apo Ptolemeu, një person mendjehollë, i cili ishte shok i fëmijërisë së Aleksandrit. Megjithatë dashuria ndaj Hephaestionit dominonte dhe ishte shumë e fortë gjatë gjithë kohës.

Si gjeneral, Aleksandri hyn në mesin e gjeneralëve më të famshëm që janë njohur ndonjëherë në historinë e njerëzimit. Ai gjithmonë komandonte nga vija e parë e frontit dhe e udhëheqte kalorësinë krah për krah me Hephaestionin. Aleksandri ishte plagosur me çdo lloj arme që ekzistonte në atë kohë. Një herë ai u plagos me shigjetë në gjoks. Me këto veti, Aleksandri i inspiroi ushtarët e tij të cilët e ndoqën atë për mbi 30.000 km (në këmbë) për tetë vite në misionin e tij për të pushtuar botën.

Dhe më në fund

Nga jeta e Aleksandrit mund të mësojmë një gjë. Ju mund të jeni mbret, mund të pushtoni botën, mund të bëheni edhe Zot, por kur i dashuri i juaj vdes, çdo gjë bëhet e pavlefshme dhe ju do të ndiqni rugën e tij.



Homoseksualët duhet të integrohen dhe të jenë të barabartë në shoqërinë kosovare.

Mendoj se në Kosovë duhet më shumë angazhim për jetën dhe të drejtat e homoseksualve si nga ana zyrtare ashtu edhe nga organizatat e ndryshme. Atyre iu duhet mbështetja e rrethit ku jetojnë, ata nuk janë njerëz të sëmurë. Unë personalisht jam shokuar kur kam dëgjuar nga disa persona (mjek) mendimin, se homoseksualët janë "persona të sëmurë dhe ata duhet izoluar nga shoqëria në një vend të caktuar ku duhet nënshtruar kurimit". Kjo të shtyn të mendosh në hipokrizi kur dëgjon gjykime të tilla nga persona që ndoshta e kanë të freskët betimin e Hipokratit se do të kujdesen për shëndetin e qenieve njerëzore.

Atëherë çfarë mund të pritet nga shoqëria, këtu dua të cekë njerëzit e rëndomtë të cilët kanë më pak njohuri për këtë dhe vështirë binden se kjo është një dukuri që lind dhe krijohet nga natyra e cila e ka krijuar edhe mbarë njerëzimin. Mendoj se kësaj çështjeje duhet t'i qasemi pozitivisht me qëllim të vetëdijësimit të opinionit: se ata nuk janë as më shumë e as më pak se qenie njerëzore, si gjithë të tjerët, po ashtu kanë të drejtë të jetojnë ashtu si ndihen më mirë. Ne në këtë botë të gjithë kemi ardhur të barabartë dhe se askush nuk ka drejtë të kufizojë ndjenjat e askujt pa dallim kombi, religjioni, race etj. Duhet punuar shumë në këtë drejtim për të informuar drejt qytetarët e Kosovës.

A.B - Prishtinë

Aty ku shkelet e drejta e njeriut, fjala demokraci e humb kuptimin e vet.

Ne duhet t'i pranojmë gejë të ashtu siç janë e jo si çka janë. Nëse ata ndihen të afërt emocionalisht me gjininë e njëjtë nuk është e drejtë të mundohemi t'i ridrejtojmë ndjenjat e tyre, po ashtu as t'i neglizhojmë ata. "Ata ose Ato janë vetja dhe si të gjithë ne edhe ata ose ato nuk kanë mundësi të shmangies nga vetja e tyre, fundja ky është realiteti i jetës së tyre".


Ekziston vetëm një jetë, andaj çdo ditë duhet jetuar si të ishte e fundit. Humanitet nuk do të thotë vetëm të ndihmohesh materialisht, por humanitet është edhe mbështetja e shoqërisë pavarësisht se cilin komunitet i takon.

Në Kosovë, po ashtu duke mos lënë anash edhe vendet e rajonit kanë paragjykime se personat që dashurojnë gjininë e njëjtë kanë probleme shëndetësore.

Të shpresojmë se paragjykimet e tilla mos të jenë afatgjata në shoqërinë tonë. Ne duhet të jemi të hapur me ata.

"Një buqetë me lule të ndryshme është shumë më e bukur sesa një me lule të njëjta".

Me këtë mesazh e perfundon mendimin e menjëherë D.D nga Prishtina.




HEPATITI B

Çka është Hepatiti B?

Hepatiti B është sëmundje e rëndë e mëlçisë e shkaktuar nga virusi i Hepatitit B (HBV).

Është jashtëzakonisht infektues dhe mund të transmetohet seksualisht ose nëpërmjet kontaktit me gjakun apo lëngjet trupore të kontaminuara.

Hepatiti B direkt e sulmon mëlçinë dhe mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme, dëmtimin e mëlçisë dhe në disa raste edhe vdekjen.



Edhe pse nuk ka shërim për Hepatitin B, ekziston vakcina e sigurt dhe efikase e cila e parandalon këtë sëmundje.

Si mund të infektoheni me virusin e Hepatitit B?

Hepatiti B mund të transmetohet nëpërmjet:

- Kontaktit seksual të pambrojtur (vagjinal, anal dhe oral) me personin e infektuar;

- Marrëdhënies seksuale me më shumë se një partner;
- Përdorimit të shiringave të përbashkëta, drogat intravenoze;
- Zhiletave dhe gjilpërave për tatuazheve të infektuara;
- Marrjes së transfuzionit dhe trajtimit me gjak apo produkte të gjakut;
- Shtatzënisë ose lindjes;
- Ekspozimi i gjakut dhe i lëngjeve të tjera të trupit të personit të infektuar te personeli mjekësor;

Hepatiti B ndryshe nga Hepatiti A nuk përhapet nëpërmjet ushqimit dhe ujit.

Si mund të mbroheni nga Hepatiti B?

Vaksinimi është mënyra më e mirë për të zvogëluar rrezikun për infektim me virusin e Hepatitit B. Rekomandohet që vakcina t'u jepet:

- Personave të cilët janë të përfshirë në sjellje me rrezik të lartë (seksi i pambrojtur, ndërrimi i shumë partnerëve, përdorimi i përbashkët i shiringave);
- Të gjitha foshnjeve;
- Adoleshentëve;
- Personave të cilët jetojnë me persona të infektuar me Hepatit B;

Mënyrat tjera për ta zvogëluar rrezikun janë:

- Përdorimi i kondomit latex gjatë marrëdhënies seksuale;
- Kufizimi i numrit të partnerëve seksual;
- Mospërdorimi i shiringave të përbashkëta;

HEPATITI B dhe C

- Mospërdorimi i drogave intravenoze;
- Mos shpimi;
- Mosbërja e tatuazheve;
- Zbatimi i masave standarde të mbrojtjes nëse jeni punëtorë shëndetësor;

Cilët janë simptomat e Hepatitit B?

Shumica e personave me Hepatit B nuk kanë ose kanë shumë pak simptoma. Nëse simptomat paraqiten, më të zakonshme për Hepatitin B janë:


- Lodhja;
- Vjellja;
- Ethet;
- Urina me ngjyrë të mbyllët;
- Barkqitja e lehtë;
- Të zverdhurit e lëkurës dhe syve;
- Dhembje në anën e djathtë;

Si diagnostikohet Hepatiti B?

Hepatiti B mund të diagnostikohet me anë të testit të gjakut.

A ka trajtim apo shërim për Hepatitin B?


Shumica e njerëzve mund të luftojnë virusin e Hepatitit B pa u zhvilluar në Hepatit B kronik. Për ata të cilët nuk mund ta luftojnë Hepatitin B ekzistojnë grupe të ilaçeve për trajtimin e Hepatitit B. Trajtimi për Hepatitin B nuk është efikas për secilin. Vetëm mjeku specialist mund të vendos për llojin e trajtimit më adekuat. Trajtimi për Hepatitin B kronik është më efikas për personat me: nivel të ulët të virusit të Hepatitit B në gjak, shumë enzime në mëlçi, etj.



HEPATITI C

Çka është Hepatiti C?

Hepatiti C është sëmundje serioze e mëlçisë e shkaktuar nga virusi i Hepatitit C (HCV). Hepatiti C direkt e sulmon mëlçinë që mund të shkaktojë dëmtimin e saj dhe në disa raste edhe vdekjen.



Si mund të infektoheni me virusin e Hepatitit C?

Hepatiti C kryesisht përhapet nëpërmjet kontaktit me gjakun e infektuar. Hepatiti C mund të përhapet nëpërmjet:

- Përdorimit të shiringave të përbashkëta, drogat intravenoze;
- Përdorimit të brisqeve, gjilpërave për tatuazhe dhe instrumenteve për shpim, të cilat janë të infektuara;
- Transfuzionit të gjakut dhe produkteve të kontaminuara të gjakut me HCV si dhe

HEPATITI B dhe C

përmes hemodializës në rastet kur kemi të bëjmë me pajisje të kontaminuara me HCV;

- Kontakteve seksuale (vagjinale, anale dhe orale) me personin e infektuar;
- Shtatzënisë dhe lindjes;

Si mund të mbroheni nga Hepatiti C?

Për Hepatitin C nuk ka vaksinë mbrojtëse. Përtë zvogëluar rrezikun:

- Shmanguni përdorimit të përbashkët të shiringave dhe drogave intravenoze;
- Shmanguni shpimit të veshëve apo pjesëve tjera të trupit për arsye jo mjekësore si dhe tatuazheve;
- Nëse jeni punëtorë shëndetësor praktikoni masat standarde të mbrojtjes;

Edhe pse rreziku i transmetimit të virusit të Hepatitit C gjatë seksit është më i vogël, përdorni kondomët me partnerët tuaj seksual.

Cilat janë simptomat e Hepatitit C?

Shumica e personave të infektuar me Hepatitin C nuk kanë ose kanë shumë pak simptoma. Nëse simptomat paraqiten atëherë më të zakonshmet për Hepatitin C janë:


- Lodhja, vjellja, ethet;
- Urina me ngjyrë të mbyllët;



- Barkqitja e lehtë;
- Zverdhja e lëkurës dhe syve;
- Dhembja në fund të shpinës që përshkon anën e djathtë;

Si diagnostikohet Hepatiti C?

Hepatiti C diagnostikohet me anë të testit të gjakut.



A ka trajtim apo shërim për Hepatitin C?

Ekziston trajtimi për Hepatitin C, i cili nuk është efikas për secilin. Vetëm mjeku mund të vendos se cili trajtim është më adekuat. Trajtimi i Hepatitit C mund:

- Të largojë virusin e Hepatitit C nga trupi i juaj;
- Të ndalojë apo ngadalësojë dëmtimin e mëlçisë;
- T'u bëjë të ndiheni më mirë;

Jo gjithmonë ky trajtim mund t'i arrijë këto efekte.


Shoqata "Elysium" është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2002 me synim për të punuar intensivisht në fushën e të drejtave të komunitetit gej në Kosovë, duke besuar se në një shoqëri demokratike janë të domosdoshme të gjitha alternativat që japin kontributin e tyre në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Synimet kryesore të shoqatës janë:

- Forcimi dhe ngritja e vetëbesimit në komunitetin gej;
- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komunitetit gej;
- Krijimi i rrethit tolerues në shoqërinë tonë;
- Lobimi me OJQ-të e tjera për të plotësuar ligjet kundër diskriminimit të bazuara në Konventat Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut;
- Monitorimi i institucioneve ligjore dhe gjyqësore në aplikimin e ligjeve kundër diskriminimit të aplikuar në Kosovë;
- Përkrahje dhe këshillim për personat gej;
- Sensibilizimi dhe dhënia e informatave të drejta për personat gejë te popullata e përgjithshme e Kosovës nëpërmjet medimeve të ndryshme të informimit;



Botues:
Shoqata "Elysium"



elysium@gaykosova.org
www.gaykosova.org

Financuar nga:



SWEDISH INTERNATIONAL DEVELOPMENT
COOPERATION AGENCY

